



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 148/14 Prot.

Tiranë, më 15.07.2026

VENDIM

Nr. 54 Datë 15.07 2026

**“PËR
MBËSHTETJEN E KËRKESAVE TË PARASHTRUARA NË PETICIONIN ME NR.3021/32
DATË 10.07.2026”**

Mbështetur në nenin 49, të Ligjit nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL-të e RSH", Vendimit nr.57, datë 29.01.2020 "Për dhënien e statusit të veçantë Universitetit të Sporteve të Tiranës, si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e sportit në Republikën e Shqipërisë", nenit 7, nenit 43 të Statutit të UST, nenit 24 të Rregullores së UST-së, në vijim të Peticionit me nr.3021/32 datë 10.07.2026 me lëndë "Petition për shqyrtimin e njoftimeve mbi detyrimet e pretenduara ndaj stafit dhe studentëve, garantimin e së drejtës për informim dhe dëgjim, mbrojtjen e pagës, pezullimin e çdo veprimi financiar, nisjen e hetimit administrativ dhe trajtimin e çështjes edhe si sinjalizim administrativ", në Vendimin e Senatit Akademik nr. 108 datë 13.07.2026, Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 15.07.2026:

V E N D O S I :

1. Miratimin e Vendimit të Senatit Akademik nr. 108 datë 13.07.2026 “Për mbështetjen e kërkesave të parashtruara në Peticionin me nr.3021/32 datë 10.07.2026”.
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Administratori i Universitetit të Sporteve të Tiranës.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen www.ust.edu.al.

KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Artur ÇOBANI

